



BULETIN MUJOR

MARS 2026



PËRMBAJTJA

- Nis procesi për përzgjedhjen e ekipit kombëtar në ECSC 2026
- Shqipëria mikpret Balkan Cybersecurity Days 2026 në Shkodër
- AKSK pjesë e MatchMaker Albania
- Zhvillimi i talenteve të reja në fokus të Cybersecurity Talent Club
- Trajtime të vazhdueshme me infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme
- Shqipëria renditet në vendin e 9-të në botë për sigurinë kibernetike sipas NCSI 2026

Nis procesi për përzgjedhjen e ekipit kombëtar në ECSC 2026



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka nisur fazat kualifikuese për përzgjedhjen e ekipit që do të përfaqësojë Shqipërinë në European Cyber Security Challenge (ECSC), kompeticioni më i madh evropian për talentet e reja në fushën e sigurisë kibernetike.

Rreth 150 aplikantë u njohën me formatin e garës dhe procesin e përzgjedhjes, ndërsa gjatë fazave kualifikuese do të përballen me sfida praktike për të identifikuar kandidatët më të spikatur që do të përfaqësojnë vendin në këtë arenë ndërkombëtare.

ECSC 2026 do të zhvillohet në Gjermani, Bochum, nga data 12–16 tetor 2026.

Shqipëria mikpret Balkan Cybersecurity Days 2026 në Shkodër

Edicioni i katërt i Balkan Cybersecurity Days 2026 u zhvillua në Shkodër, duke mbledhur ekspertë, institucione dhe përfaqësues të sektorit privat nga rajoni dhe më gjerë.

Konferenca, e organizuar nga AKSK në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë si DCAF dhe FIRST, shërbeu si një platformë për diskutimin e kërcënimeve aktuale, zhvillimeve në politikën e sigurisë dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal.

Diskutimet theksuan se sfidat kibernetike kërkojnë koordinim të vazhdueshëm ndërmjet vendeve për të rritur qëndrueshmërinë kolektive.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



[@aksk.gov.al](https://www.instagram.com/aksk.gov.al)



+355 422 21 039

MARS 2026

AKSK pjesë e MatchMaker Albania

Në kuadër të MatchMaker Albania, AKSK kontribuoi përmes një workshop-i të dedikuar mbi "Cyber Incident Response".

Gjatë këtij sesi u prezantuan praktikat më të mira për identifikimin, analizimin dhe reagimin ndaj incidenteve në kohë reale, si dhe u trajtuan qasje konkrete për koordinimin ndërinstitucional dhe shkëmbimin e informacionit.

MatchMaker Albania është një platformë që synon të nxisë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike, sektorit privat dhe inovatorëve, duke krijuar hapësira për shkëmbim idesh, zhvillim partneritetesh dhe promovim të inovacionit.



Zhvillimi i talenteve të reja në fokus të Cybersecurity Talent Club

Gjatë muajit mars, në kuadër të aktiviteteve të Cybersecurity Talent Club, u zhvilluan disa sesione të fokusuar në reagimin ndaj incidenteve kibernetike dhe vendimmarrjen në situata reale.

Përmes diskutimeve praktike dhe ndarjes së përvojave nga ekspertë të fushës, pjesëmarrësit u njohën me sfidat dhe mekanizmat e mbrojtjes së sistemeve dhe të dhënave.

Këto aktivitete kontribuojnë në zhvillimin e aftësive profesionale dhe në përgatitjen e talenteve të reja për përballimin e sfidave në rritje të sigurisë kibernetike.



Trajnime të vazhdueshme me infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme

Në vijim të programit të takimeve të përjavshme, AKSK zhvilloi disa sesione me infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme të informacionit, të fokusuar në:

- raportimin dhe menaxhimin e incidenteve kibernetike
- identifikimin dhe analizimin e alerteve të sigurisë
- forcimin e mekanizmave të koordinimit dhe reagimit

Përmes këtyre trajnimeve dhe simulimeve praktike, u rrit gatishmëria operationale dhe u konsoliduan kapacitetet për përballimin efektiv të kërcënimeve kibernetike.

AKSK, në bashkëpunim me DCAF, synon rritjen e gatishmërisë së institucioneve, forcimin e qëndrueshmërisë kibernetike dhe përmirësimin e mekanizmave të reagimit ndaj incidenteve në nivel kombëtar.


Shqipëria renditet në vendin e 9-të në botë për sigurinë kibernetike sipas NCSI 2026

Shqipëria ka arritur një tjetër progres të rëndësishëm në fushën e sigurisë kibernetike, duke u renditur në vendin e 9-të në botë sipas National Cyber Security Index (NCSI), me një rezultat prej 92.5 pikësh

Ky pozicionim përfaqëson një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me vitet e mëparshme, duke reflektuar një ngjitje të qëndrueshme nga vendi i 54-t në vitin 2023 dhe vendi i 15-të në vitin 2025, drejt një renditjeje ndër vendet më të avancuara në nivel global në këtë fushë.

Sipas raportit, Shqipëria vlerësohet për progresin në forcimin e strukturave përgjegjëse për sigurinë kibernetike, zhvillimin e politikave dhe strategjive kombëtare, si dhe për përmirësimin e mekanizmave të koordinimit dhe reagimit ndaj kërcënimeve në hapësirën digjitale.

Shqipëria ngjitet në renditjen globale të sigurisë kibernetike



NCSI EGA



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



@aksk.gov.al



+355 422 21 039